



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010) nenin 4, paragrafi 3 dhe nenin 13 paragrafi 3 të Ligjit 05/L-045 për sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2016 miratoi

## **RREGULLORE PËR HAPJEN E ZYRAVE PËRFAQËSUESE BRENDA REPUBLIKËS SË KOSOVËS NGA SIGURUESIT E JASHTËM**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e aprovimit për hapjen e një zyre përfaqësuese brenda Republikës së Kosovës nga siguruesit e jashtëm.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjithë siguruesit e jashtëm të cilët synojnë të marrin leje nga BQK-ja për të hapur një zyrë të përfaqësimit në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-45 për sigurimet në Kosovë (në vijim: Ligji për sigurimet) dhe/ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
  - a) *Sigurim* - do të thotë transferim i një rreziku të mundshëm, i një humbjeje pasurore/dhe ose shoqëri aksionare nga i siguruari te siguruesi, sipas një kontrate sigurimi;
  - b) *Sigurues i jashtëm* - do të thotë personi që është i organizuar, ka selinë e vet dhe posedon licencë për t'u angazhuar në veprimtari të sigurimeve në ndonjë juridiksion tjetër përveç Kosovës;
  - c) *Zyrë përfaqësuese* – vend të aktivitetit afarist, i cili formon një degë ligjërish të varur të siguruesit të pa themeluar në vete, ku aktivitetet kufizohen në ofrimin e informatave dhe aktiviteteve të ndërlidhjes, si dhe studimit të tregjeve dhe mundësive për investim ku siguruesi nuk do të angazhohet në veprimtari të sigurimeve.

### **Neni 3**

#### **Kërkesat për hapjen e zyrës përfaqësuese brenda Republikës së Kosovës**

1. Siguruesi i vendit të jashtëm, i cili aplikon për hapjen e zyrës përfaqësuese në Republikën e Kosovës siç është e përcaktuar në nenin 13 të Ligjit për sigurimet duhet të marrë leje paraprake nga BQK-ja.
2. BQK-ja do të japë lejen për hapjen e një zyre përfaqësuese të siguruesit të huaj në Republikën e Kosovës, pasi të ketë analizuar dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) vendimin e organit kompetent të siguruesit të huaj për hapjen e zyrës përfaqësuese;
  - b) qëllimin e hapjes së saj;
  - c) kohëzgjatjen e parashikuar të veprimitarisë së zyrës përfaqësuese, adresën dhe numrin e telefonit;
  - d) emrat e personave të propozuar si drejtorë të zyrës së përfaqësimit të shoqëruar me curriculum vitae të tyre (arsimimin, profesionin, eksperiencën etj.);
  - e) numrin e parashikuar të punonjësve të zyrës;
  - f) dokumentin e regjistrimit të zyrës përfaqësuese në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe
  - g) ndonjë aprovim nëse kërkohet nga autoriteti mbikëqyrës i vendit përkatës për hapjen e zyrës përfaqësuese.
3. Zyra përfaqësuese e siguruesit të huaj duhet të regjistrohet dhe të përdor të njëjtin emër me atë të siguruesit amë, duke shtuar fjalët “Zyrë përfaqësimi”.
4. Zyra përfaqësuese mund të kryejë funksione të përfaqësimit dhe/ose administrative, ndonjë aktivitet promocional apo kërkime në treg në funksion të aktivitetit që ushtron siguruesi i huaj, apo që ky i fundit parashikon të ushtrojë në të ardhmen në Republikën e Kosovës.
5. Zyra e përfaqësimit nuk mund të kryejë asnjë lloj veprimtarie të sigurimeve apo veprimtari tjetër komerciale.
6. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike prej datës së pranimit të aplikacionit në zyre përfaqësimi, BQK-ja aprovon ose refuzon kërkesën.

### **Neni 4**

#### **Ndalesa**

Asnjë person nuk mund të angazhohet në veprimtari të sigurimeve, pa siguruar paraprakisht licencën nga BQK-ja. Kryerja e veprimitarisë së sigurimeve pa posedim të licencës, do të jetë subjekt i ndëshkimeve sipas legjislacionit në fuqi.

**Neni 5**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha rregullat, rregulloret dhe udhëzimet që rregullojnë këtë çështje.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 prill 2016.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Prof. Dr. Bedri Peci